



## SEKSIONI I SHKENCAVE NATYRORE DHE SHOQËRORE

### Analizë e romaneve "KREUZTANNE"(Udhëkryq) dhe NILCON të autorit Fate Velaj

Msc. Suela Koreta

#### Abstract

In the autobiographical novels "Kreuztanne" and "Nilcon", which constitute the first and second part of the trio "Kreuztanne", the author confesses about his life, his suffering in emigration, in search of a dream, expresses his views on art, society and holds a certain attitude towards the people and events he speaks. They are indicative of a talented creator who, even in this kind of art, shone forth among the most literary creators.

**Keywords:** confess, art, society, creator, talent, dream.

#### Abstrakt

Në romanet autobiografike "Kreuztanne" dhe "Nilcon", të cilët përbëjnë pjesën e parë dhe të dytë të triologjisë "Kreuztanne", autori rrëfen për jetën e tij, vuajtjet në emigracion, në kërkim të ëndërrës, shpreh pikëpamjet e tij për artin, shoqërinë dhe mban qëndrim të caktuar ndaj njerëzve e ngjarjeve për të cilët flet. Ato janë tregues i një krijuesi plot talent, që edhe në këtë lloj arti shkëlqeu, duke u radhitur ndër krijuesit letrarë më me zë.

**Fjalë kyce:** rrëfen, art, shoqëri, krijues, talent, ëndërr.

\* \* \*

Në romanet autobiografike "Kreuztanne" dhe "Nilkon", të cilët përbëjnë pjesën e parë dhe të dytë të triologjisë "Kreuztanne", autori rrëfen për jetën e tij, vuajtjet në emigracion, në kërkim të ëndërrës, shpreh pikëpamjet e tij për artin, shoqërinë dhe mban qëndrim të caktuar ndaj njerëzve e ngjarjeve për të cilët flet. Ato janë tregues i një krijuesi plot talent, që edhe në këtë lloj arti shkëlqeu, duke u radhitur ndër krijuesit letrarë më me zë.

Si artist, ideator bashkëpunimesh e nismash, siç është nisma "Arti përmirëson kohën", autori shpalos pikëpamjet e tij për artin dhe rolin e tij në jetën shoqërore. Ja çfarë shkruan autori në faqet e romaneve: "Arti është respekt, është ndjenjë, është bashkim ndjenjash të përbashkëta. Arti bën ndryshimin. Ndërton ura për komunikim". (Nilkon, f.101)

"Arti përmirëson marrëdhëniet mes njerëzve. Por, përpara se të jesh artist, je një njeri që jeton mes njerëzve, mes problematikave të tyre dhe si krijues, si pararojë e shoqërisë që je, duhet të japësh mendime dhe në fund

këshilla korrektuese, të ofrosh zgjidhje". ( Nilkon, f.114).

Po kështu autori është iniciator i nismës "Midis Danubit dhe Nilit", që i mahnit të gjithë me idetë novatore, nisur dhe nga të dhënat historike se pellgu i Mesdheut ka qenë djepi i kulturës botërore e si i tillë ai duhet ringjallur duke rishtuar vlera të reja, ku të dy lumenjtë simbolizojnë vlerat kulturore dy kontinenteve, Danubi rrjedh nëpër Evropë dhe Nili në kontinentin afrikan, por që në këtë pellg bashkohen. Autori bën apel për paqen, ruajtjen, rifreskimin dhe pasurimin e këtyre vlerave dhe si njeriu që ka për mision shpirtëror ndërtimin e urës artistike mes kësaj hapësire shkruan: "Një ekspozitë këtu në galerinë tuaj, -, iu drejtova dorën nga salla ku kishim qenë më parë dhe një në Kajro, si një dialog i kulturave dhe civilizimeve midis artistëve nga hapësirat ku kalon lumi i Danubit dhe atyre të Nilit". (Nilkon, f.205).

Këto flasin për një artist vizionar, me botë të gjerë që bën vlerësim maksimal për këtë fushë mjaft të rëndësishme të veprimtarisë shoqërore, jo si diçka të mbyllur në vetvete, por si mjet që ndihmon në bashkimin shpirtëror të kombeve, si urë lidhëse mes tyre e duke ndihmuar kështu në proceset integruese politike rajonale e botërore.

Qysh në prologun e romanit "Udhëkryq", autori prezanton motivin, shtysat për një ndërmarrje të tillë artistike. "Ideja për të shkruar këtë libër më lindi në 24-vjetorin e ardhjes sime në Austri. Atë ditë të vitit 1991, pas një udhëtimi të gjatë e të rrezikshëm nëpër Jugosllavinë ku sapo kishte filluar lufta, i vetëm e me një qese me pak rroba me vete dhe me 100 marka gjermane në xhep, mbërrita në fund, mbas 28 orësh, në "Lager", në Traiskirchen, një qytet 20 kilometra larg Vjenës". f.7

Kujtimet e pashlyera lënë në kujtesën e tij, ku te ky udhëkryq dhe në kuvendim me malet e larta stoike, u "këshillua" për rrugën që duhet të zgjedhte, ai shkruan: "U ula përsëri në korridor dhe me sytë drejtuar maleve që qëndronin kokëforta, kryeneçe e muskulore si të donin të më thoshin se ne jemi të zotët e vendit e se ti do të bësh çfarë të duam e të ta lejojmë ne....." f.35

Dhe pas 24-vjetësh kthehet sërish në këto treva ndoshta për t'u kthyer atyre "borxhin" e për t'u shprehur atyre falenderimin e mirënjohjen, për këshillimin për rrugën e zgjedhur e suksesin e arritur.

Padyshim, që përvoja si piktor, ka ndihmuar autorin për realizimin e këtyre ideve e për t'u marrë me një lloj tjetër arti, me letërsi, e cila duket se ka qenë pasioni i tij hershëm



dhe fusha që e bëri atë të famshëm dhe ku ai gjen vetveten. Këto dy lloje arti duke pasur objekt pasqyrimi realitetin, e realizojnë atë me mjete të ndryshme e specifike, ku njëra përdor ngjyrën dhe tjetra fjalën, prandaj dhe letërsia quhet art i fjalës. Në vepër duken sikur ngjyra dhe fjala shkrihen në një mjet sinkretik, duke na dhënë tablo të gjalla të cilat janë piktura të shprehura me fjalë nga realiteti në emigrim dhe ai shqiptar i pas viteve '90, i asaj jete plot dhimbje e vështirësi në emigracion në kërkim të realizimit të ëndrrave.

Ndonëse romane me detaje autobiografike, në to nuk është e vështirë të zbulohet forca tipizuese e përgjithësuese e tyre për fatin e përbashkët të gjithë emigrantëve dhe sidomos të rinjve bashkëmoshatarë të autorit dhe jo vetëm shqiptarë, por nga gjithë vendet ish-komuniste, që të mbetur pa shpresë e të ardhme në vendet e tyre, rendën kudo në Perëndim duke kërkuar një jetë më të mirë për realizimin e ëndrrave. Vetë autori përfaqëson atë brez ëndërrimtarësh ku realiteti ishte një shkollë e madhe për formimin e tyre.

Ja çfarë shkruan autori: "*Vazhdoja t'i tregoja historinë time duke u thënë se tërë jetën kam pas ëndërruar të jetoja në Romë, se ëndërra më la po atë ditë kur anijet mbusheshin me ëndërrimtarë të tjerë...që kishin ikur nga portet e Durrësit e Vlorës, për të cilat kishin raportuar të gjitha stacionet e botës*". (Kreuztanne, f.23).

Nëse do t'i bënim një analizë planeve të veprimit në roman do të dallonim këto plane:

**a.Planin personal** (vetë autori i mbetur i pashpresë në kërkim të një jete më të mire dhe realizim të ëndrrës);

**b.Plani moshor** ( të njëjtën dramë përjetuan gjithë të rinjtë shqiptarë);

**c.Plani shoqëror** ( drama e mijëra shqiptarëve të mbetur në udhëkryq, demonstratat me slloganin "E duam Shqipërinë si gjithë Evropa")

**d.Plani ndërkombëtar** (solidariteti me mijëra emigrantë të vendeve ish-komuniste që po emigronin masivisht në Perëndim).

Veprat janë të mbushura me episode nga jeta e përditshme, shoqëruar me një rrëfim realist, dialog ekspresiv duke kaluar me mjaft mjeshtëri nga një episod në tjetrin, me përshkrime shumë të hollësishme për çdo gjë.

P.sh.: "*Ula kokën dhe shihja mobiljet e rënda që kushedi sa vjeçare ishin dhe vendosa dorën për ta shtypur kolltukun prej lëkure ku isha ulur si për të provuar suspacionin e saj me idenë në kokë se në të tillë kolltuk nuk isha ulur ndonjëherë më parë*".

Disa herë në roman autori përdor **retrospektivën** duke hedhur vështrimin në Shqipërinë e kohës moniste, gjyqeve politike të saj, etj. Ja si shprehet ai: "*Filloja t'i flisja për Melon, babain tim dhe shkollën që kishte mbaruar në Moskë e punën që kishte bërë mes frikës dhe ankthit të rezultateve që ishin të parashkuara e që duhet të realizoheshin me patjetër mbasi, do të kishte fatin e shokëve të tij, të cilët u pushkatuan dhe u burgosën vetëm e vetëm se nuk gjenin naftë aty ku "duhej" të gjenin*". (Kreuztanne, f.23).

E veçanta e stilit të tij është aftësia e lartë fytyruese ose aftësia për të na ngjallur në përfytyrimin tonë shëmbëllime të vendeve, të njerëzve, të veprimeve, etj.,

prandaj duken sikur i kemi pamje të gjalla.

Dihet se kushdo që përpiket të kuptojë një tekst a një thënie të shkruar ose të folur, doemos duhet të hyjë në analizën e atyre mjeteve të shprehjes që e ndërtojnë këtë tekst, d.m.th të kuptojë fjalët, lidhjet e tyre, fjalitë, vlerat e mjeteve në rrethin e tekstit.

E konceptuar si ndërtesë, vepra letrare është para së gjithash një krijim gjuhësor, sepse gjuha është lënda prej së cilës ajo ndërtohet ose siç thuhet është goja e letërsisë. Ajo dallohet nga gjuha e të folurit të përditshëm, sepse shfaqet si sistem i ri kuptimor.

Ne jemi ndalur sidomos në ato lidhje fjalësh nga ku dhe lindin kuptimet e figurshme, pasi kuptimet e figurshme të fjalëve nuk përbëjnë përmbajtjen e drejtpërdrejtë të tekstit, por përmbajtjen e nënkuptuar apo "nëntekstin". Si pasqyrim artistik i realitetit letërsia nuk bën dot pa kuptimet e figurshme, pa përdorimin e fjalëve me dendësi kuptimi dhe vëllimi të madh informacioni.

Duke i vendosur fjalët në lidhje të reja e në gjendje të reja ligjërimore, zgjerohet rrethi i kuptimeve dhe i ngjyimeve stilistike. Fjala merr kuptim të figurshëm brenda disa lidhjeve fjalësh ose kontekste strukturash minimale, të cilat janë vatrat e lindjes së kuptimeve të figurshme.

Kalim i të njëjtit emërtim edhe për një send tjetër realizohet me mjete të ndryshme. Ai mund të bëhet sipas ngjashmërisë së sendeve në një tipar: në lëndën, në funksionin themelor, në formën, etj..., d.m.th mbi bazën e metaforës. Mbi këtë bazë tiparet e frymorëve mund t'i marrin jofrymorët dhe anasjelltas.

Duke i vëzhguar me kujdes romanet nuk mund të mos t'i evidentosh këto struktura si vatra të ngjizjes së kuptimeve të figurshme. Jemi munduar t'i qëmtojmë ato si kur autori përshkruan, ashtu dhe në dialogjet, monologjet, etj.

Kemi bërë objekt lëvizjen kuptimore që kanë në bazë **metaforën**. Këtë kuptim të ri e realizojnë lidhje të tilla fjalësh ku jofrymorëve u vihen cilësitë e frymorëve duke i animizuar e duke u dhënë jetë atyre si dhe anasjelltas.

Brenda botës metaforike kemi dalluar dy lloje kalime emërtimesh mbi bazën e ngjashmërisë:

a.Tiparet e frymorëve u kalojnë jofrymorëve.

Kjo përbën lëvizjen kryesore kuptimore dhe struktura të tilla në roman i gjejmë mjaft dendur,si:

*Malet qëndronin kokëforta, qëndronin kryeneçe, qëndronin muskulore, etj.*

Po i ilustruam me shembuj:

*"U ula përsëri në korridor dhe me sytë drejtuar maleve që qëndronin kokëforta, kryeneçe e muskulore si të donin të më thoshin se ne jemi të zotët e vendit e se ti do të bësh çfarë të duam e të ta lejojmë ne....."* f.35

Ose:

*"Na thanë se lumi Erlauf ishte shumë xanxar dhe në pranverë me fillimin e shkrirjes së dëborës ai fryhej, tregonte muskujt dhe përmbyste çdo gjë që i dilte përpara"*.f.66

*"Vjena nuk ankohej më nga dhimbjet e reumatizmit..."* f.167

*"I nxehti kishte hyrë thellë nëpër eshtra, brinjë, madje ua kishte tharë ujin mushkërive të qytetit..."*

*"Tetori kishte hyrë i qetë dhe i mbarë për punë"* f.55

b.Tiparet e jofrymorëve u kalojnë frymorëve

Edhe kjo është një lëvizje kuptimore e përdorur në



roman, por ajo zë vendin e dytë krahasuar me lëvizjen e parë, si: *biseda të turbullta, zë i hollë, marsi hyri i bardhë, etj.*

Në vepër, ndonëse jo dendur, gjejmë edhe ndonjë formë gramatikore të mbipërbërë, siç është forma gramatikore e mbipërbërë e së kryerës **kam pasë ëndërruar**, e cila ka kuptim të ngjashëm me atë të së kryerës dhe përdoret zakonisht për veprime të një të shkuare të largët, p.sh.: *"Tërë jetën kam pasë ëndërruar të jetoja në Romë..."*

**Kjo lëvizje kuptimore** të cilën analizuam i ka shërbyer autorit për t'i dhënë më shumë gjallëri, jetë e frymarrje të gjerë veprës së tij.

Romanet shquhen për një gjuhë të pasur duke krijuar ose rivënë në përdorim fjalë të të gjitha shtresave. Po kështu në një **analizë onomastike** të romaneve vihet re se onomastika e përdorur në përshkrimet e tij vjen shumë e pasur me elementë të shumtë të antroponimisë, toponimisë (aikonimet, etonimet, hidronimet, oronimet), etj.

**Antroponime ose emrat e njerëzve, si:** *Sabina, zonja Schuller, zonja Reitlinger, zoti Konul, Dr.Gobara, Dr.Omran, etj.*

Brenda toponimisë një grup të madh e përbëjnë, si:

**Etnonimet** (shtete, qytete): *Shqipëri, Greqi, Egjipt, Austri, Rusi, Angli, Moska, Vjena, Vlora, Tirana, Peja, Salzburg, Romë, Grazi, Keinberg, Tiroli, Kajro, etj.*

**Hidronimet** (lumenj, dete, liqene): *Danudi, Nili, Erlauf, Adriatik, liqeni Como, liqeni i Lunzit, etj.*

**Oronimet:** (male, fusha, kodra, lugina) *malet e Sankt Antonit, malet e Semeringut,*

**Si përfundim mund të themi** se dy romanet e tij shënojnë arritje cilësore e përbëjnë një krijimtari origjinale e tepër

të suksesshme të autorit. Ato janë pasuri kombëtare, të cilat e bënë atë të njohur në fushën e letërsisë. Romanet janë mbushur plot vlagë jete, ku përshkrimet e hollësishme dhe mjaft emocionuese të krijojnë përshtypjen se brenda saj, nga faqja në faqe jeta lëviz plot zigzake, kthime prapa e ecje me vendosmëri përpara në kërkim dhe realizim të ëndrrës, të asaj ëndrre që të mbush me shpresë e të jep forcë të ecësh me vendosmëri përpara.

Për autorin është e qartë se **suksesi në jetë** nuk arrihet lehtë, se për t'u bërë i famshëm kërkohet punë, mund, sacrificë, vizion, e mbi të gjitha vullnet dhe këmbëngulje. Vuajtjet, rëniet dhe ngritjet në jetë janë një shkollë e madhe, ato nuk duhet të të deziluzojnë, sepse jeta të ofron të mirat dhe të këqijat e saj ndaj ti edhe kur bie duhet të ringrihesh, të marrësh forcë të ecësh përpara për të filluar **jetën e re, epokën e re në përkushtim dhe realizim të ëndrrës së re.**

Ja çfarë shkruan autori: *"Puna në fabrikë kishte kohë që e kishte humbur rëndësinë për mua. Nuk më bënë më këmbët të shkoja më. Isha i përkushtuar te arti im që kishte kohë që kishte fituar terren mbi çdo gjë tjetër. Do të filloja një **jetë të re**, t'i përkushtohesha tërësisht një **ëndrre të re**. Ajo e kuptoi që bëhej fjalë për artin dhe kulturën, buzëqeshi dhe më uroi rrugë të gjatë e plot suksese". "Tashmë për mua kishte filluar një **epokë e re**, një epokë ku idetë dhe fantazitë në terrene të panjohura do ishin parësore dhe se të tjerat do të ishin zhvillime të tyre dhe se çdo gjë do t'i dedikohet një pune të paepur e plot kurajë për të arritur aty ku dëshiroja, për të cilën isha nisur nga **Shqipëria**". f.285*

## Referime bibliografike

Thomai, J., "Prejardhja semantike në gjuhën shqipe", Tiranë, 1989

Greimasi, A., "Semantique"

Xhuvani, A., "Vepra", vëll. I, 1980

Ismaili, R., "Shumësia e tekstit", Prishtinë, 2004